

**STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"ALU CONSTRUCTION" SHPK**

KREU I  
EMERTIMI-OBJEKTI-QENDRA-KOHEZGJATJA

**Neni 1-Formimi i shoqërisë**

Sot në Tiranë në datën 25.11.2024, themelohet shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuara e emërtuar "ALU CONSTRUCTION" SHPK, me vullnetin e lirë të ortakëve, Bazuar në kërkesat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare" dhe të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit"

Shtetase Shqiptare

a) **Zj. BLERTA CAUSHLLARI**, e bija e Asllan, e datëlindjes 17.05.1985, lindur në Gjerbës me mjet identifikimi nr. I55517089V, me shtetësi Shqiptare, dhe banuese në Rruga "3 Dëshmorët", Lagjja nr. 6, Godinë 2 katëshe, Tiranë.

është ortake e vetme e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuari e quajtur "ALU CONSTRUCTION" SHPK

Shoqëria është person juridik dhe do ushtrojë veprimtarinë në bazë të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtaret dhe Shoqëritë tregtare" i ndryshuar.

**NENI 2–Objekti i veprimitarisë së shoqërisë**

2.1. Objekti i veprimitarisë së shoqërisë do të jetë si vijon: Tregti me pakice dhe shumice te materialeve te ndertimit dhe materiale te ndryshme dhe duralumini, etj.

**Neni 3-Kohëzgjatja e veprimitarisë**

3.1. Kohëzgjatja e veprimitarisë së shoqërisë do të jetë me afat të pacaktuar.

3.2. Me vendim te ortakëve afati i mësipërm mund te ndryshojë ose shoqëria mund të shkrihet.

**Neni 4-Vula e shoqërisë**

Shoqëria do të ketë vulën e vet në formën e përcaktuar nga ortaku.

**Neni 5-Selia e shoqërisë**

5.1. Shoqëria "ALU CONSTRUCTION" SHPK ka qendrën në Tiranë me adresë: Rr. "Babë Rexha", Tiranë.

5.2. Shoqëria do të ushtrojë gjithë veprimitarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

5.3. Shoqëria mund të çeli seli të tjera të dyta, degë, përfaqësimi si dhe agjenci operative në të gjithë territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj sipas legjislacioneve në fuqi.

*Blera*

**KREU II  
KAPITALI-KUOTAT-ORTAKËT**

**Neni 6-Kapitali i regjistruar**

- 6.1. Kapitali i shoqërisë është LEKË 100.000 (njëqind mijë).
- 6.2. Kapitali i shoqërisë është i përbërë nga 1 (një) kuotë e vetme, e cila përbën 100% të kapitalit të shoqërisë.
- 6.3. Administratori i shoqërisë Blerta Çauhillari, në cilësinë e ortakut të vetëm është zotëruese e 100% të kuotave të shoqërisë.

**Neni 7-Transferimi i kuotave**

- 7.1. Kuotat e kapitalit janë lirisht të transferueshme.
- 7.2. Kuotat e kapitalit të shoqërisë si dhe të drejtat qe rrjedhin prej tyre me vendim të ortakëve mund te fitohen apo kalohen nëpërmjet:
  - a) kontributit ne kapitalin e shoqërisë;
  - b) shitblerjes;
  - c) trashëgimisë;
  - d) dhurimit; (si personave që kanë lidhje gjaku me ortakët ashtu edhe të tjerëve pa lidhje gjaku)
  - d) çdo mënyre tjeter te parashikuar me ligj.
- 7.3. Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim dhe e noterizuar.

**Neni 8-Ortakët**

- 8.1. Shoqëria zotërohet nga tre ortakë dhe të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga te tre ortakët. Të gjitha vendimet e marra nga ortakët regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënët e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.
- 8.2. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
  - 8.2.1. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurisë se veprimtarisë;
  - 8.2.2. Shpérndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
  - 8.2.3. Investimet e reja;
  - 8.2.4. Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 8.3. Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përvçe rastit kur shoqëria vendos ndryshe.



**KREU III**  
**DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

**Neni 9-Drejtimi dhe Administrimi**

9.1 Shoqëria tregtare "ALU CONSTRUCTION" SHPK do drejtohet nga një administrator.  
*Administrator i Shoqërisë duke filluar nga data e sotme për pesë vitet në vazhdim 25/11/2024 deri 24/11/2029) do të jetë ortaku i vetëm BLERTA CAUSHILLARI.*

9.2 Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:

- 9.2.1. kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ortakët;
- 9.2.2. përfaqëson shoqerinë tregtare;
- 9.2.3. kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- 9.2.4. përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e securisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara ortakëve për miratim;
- 9.2.5. krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcenojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- 9.2.6. kryen regjistrimet dhe dërgojnë të dhënrat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- 9.2.7. raporton përpara ortakëve në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

9.3 Ortakët mund ta shkarkojë administratorin në çdo kohë. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund ta përashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Paditë, që lidhen me shpérblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqerinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

9.4. Administratori do shpërblehet sipas përcaktimit të ortakëve në përputhje me parashikimin e nenit 97 te ligjit nr.9901 date 14.04.2008. "Për Shoqëritë Tregtare".

9.5 Administratori ka të drejtë të caktojë dhe revokojë persona të tretë ne mungesë dhe përllogari të tij.

**Neni 10-Kontrolli i brendshëm**

10.1. Shoqëria tregtare organizon kontrollin e brendshëm me një kontabël të miratuar, i cili është përgjegjës përpara kësaj shoqërie për dëmet që mund të shkaktojë nga moskryerja në rregull e detyrës së tij.

**Neni 11-Bilanci dhe të ardhurat**

11.1. Veprimet ekonomike e financiare të shoqërisë mbyllen më 31 dhjetor të çdo viti përvëç rasteve e urdhreve të veçanta të ortakëve të saj. Në fund të çdo periudhe ushtrimore nxirret bilanci kontabël me rezultatin ekonomik HUMBJE FITIME.

11.2. Bilanci kontabël miratohet brenda datës 31 mars të vitit pasardhës dhe pas përcaktimit të detyrimeve fiskale pjesa që mbetet i jepet për përdorim Ortakëve të saj.

**Neni 12-Shpërbërja e shoqërisë**

12.1. Shpërbërja e shoqërisë mund të vijë në çdo kohë dhe për një ose më shumë nga shkaqet e parashikuara nga neni 99 të ligjit nr.9901 date 14.04.2008. "Për Shoqëritë Tregtare".

12.2. Në rast shkrirje të shoqërisë, Ortakët vendosin mbi mënyrat e likuidimit dhe caktojnë një

ose më shume likuidatorë duke iu përcaktuar edhe detyrat.

12.3. Në rastin e likuidimit emërtimi i shoqërisë do të shoqërohet nga shënim:  
**SHOQERI NE LIKUIDIM E SIPER.**

Administratori regjistrion prishjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

#### Neni 13-Dispozitat përfundimtare

Për sa nuk është shprehur plotësisht në këtë statut do i referohet plotësimeve të bëra nga ORTAKET.

Shoqëria "ALU CONSTRUCTION" SHPK do të jetë subjekt i të drejtës shqiptare dhe do ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me normat e legjisacionit shqiptar dhe normat e këtij statuti.

Ky statut nënshkruhet nga administratori në cilësinë e ortakut të vetëm në datë 25/11/2024.

#### ORTAKU I VETËM

#### BLERTA CAUSHLLARI

(emër, mbiemër, firmë)

